



# Rregullore për ekzekutimin më të mire (Best Execution)

Shoqëria Administruese e aseteve të Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive

## Neni 1

### Qëllimi i kësaj Procedure

1.1 Procedura e ekzekutimit më të mirë (Procedura) përcakton informacionin në lidhje me mënyrën se si ABI Invest Sha (“Shoqëria”) realizon ekzekutimin më të mirë siç kërkohet nga Ligji 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” si dhe rregulloreve në zbatim të tij, në rastet kur trajton për ekzekutim urdhra për investimet.

1.2 “Ekzekutimi më i mirë” është termi i përdorur për të treguar detyrën që ka Shoqëria që të ndërmarrë të gjithë hapat e mjaftueshëm për të arritur rezultatet më të mira të mundshme kur trajton për ekzekutim urdhëra për investimet e saj duke marrë në konsideratë rrethanat përkatëse.

## Neni 2

### Fusha e zbatimit

2.1 Kjo politikë mbulon tregtimin nga Shoqëria të instrumenteve financiare si në vijim

- a) Aksionet,
- b) Titujt e Borxhit;
- c) Kuotat ose aksionet në sipërmarrjet e investimeve kolektive;
- d) Depozitat

## Neni 3

### Faktorët e Ekzekutimit

3.1 Në përpjekje për të arritur ekzekutimin më të mirë në lidhje me një urdhër të veçantë, Shoqëria do të marrë parasysh të gjithë faktorët përkatës duke përfshirë sa vijon:

- a) çmimi: ky është çmimi me të cilin tregtohet një instrument financiar;
- b) kostot: kjo përfshin të gjitha tarifat dhe kostot që lidhen me ekzekutimin e urdhërit
- c) shpejtësia: kjo është koha që duhet për të ekzekutuar një transaksion;
- d) Probabiliteti i ekzekutimit dhe shlyerjes: ka të bëjë me probabilitetin e realizimit të transaksionit dhe të shlyerjes
- e) madhësia: ka të bëjë me shumën e urdhërit
  
- f) natyra e transaksionit ose ndonjë konsideratë tjetër në lidhje me ekzekutimin e transaksionit: kjo është mënyra se si karakteristikat e veçanta të një transaksioni mund të ndikojnë në ekzekutimin më të mirë.

3.2 Shoqëria do të përcaktojë rëndësinë relative të secilit prej faktorëve të ekzekutimit duke përdorur gjykimin dhe përvojën që ka në tregtimin e instrumentave financiare, duke u bazuar në informacionin e disponueshëm të tregut dhe duke marrë parasysh një numër kriteresh, si në vijim:

- a) Qëllimi i investimit;
- b) Karakteristikat e instrumenteve financiare që i nënshtrohen këtij urdhri, p.sh. aksione ose tituj borxhit;
- c) Llojet e vendeve të tregtimit ku mund të vendoset urdhëri
- d) Karakteristikat dhe natyra e urdhërit, përfshirë nëse janë dhënë udhëzime specifike;
- e) Kushtet e tregut, të tilla si shkalla e likuiditetit dhe luhatshmërisë në treg.

3.3 Për shumicën e transaksioneve, faktorët kryesorë të ekzekutimit mbi të cilët do të vendoset përparësia e ekzekutimit të urdhërit do të jenë si më poshtë:

- a) Mundësia e ekzekutimit / madhësisë - duke pasur parasysh madhësinë e tregtimit në tregje të ndryshme, Shoqëria mund ti japë përparësi probabilitetit për të ekzekutuar urdhërin në atë që kërkohet, që do të thotë se mund të favorizojë vendet e ekzekutimit të cilat do të lejojnë plotësimin e madhësisë së urdhërit, ose të paktën një pjesë materiale të tij. Këtu mund të jetë vecanërisht rasti kur një urdhër është i madh, ose kur një instrument i veçantë nuk është shumë i likuid;
- b) Çmimi - kjo nënkupton çmimin e instrumentit (dmth. duke mos përfshirë kostot e aplikuar nga ndërmjetësi ose vendi i ekzekutimit); dhe
- c) Shpejtësia – Duke konsideruar lëvizjet e shpejta të cmimeve të instrumentave financiare, shpejtësia mund të jetë një faktor thelbësor. Nëse Shoqëria beson që tregu mund të lëvizë shpejt në një periudhë afatshkurtër, mund t'i jepet prioritet shpejtësisë në krahasim me faktorët e tjerë

3.4 Në rastet e tregtimit në tregje në zhvillim, ku praktikat e tregut mund të jenë më pak të zhvilluara, Shoqëria do të konsiderojë edhe kostot e transaksionit si faktor ekzekutimi.

3.5 Në shumicën e tregjeve të zhvilluara mundësia e klerimit dhe shlyerjes dhe realizimit të ekzekutimit është standarte dhe realizohet sipas parimit të shlyerjes kundrejt pagesës. Megjithatë në tregje më pak të zhvilluara theksi mund të vendoset në mundësinë e klerimit dhe shlyerjes së titullit pasi mund të mos kenë krijuar ende të gjithë infrastrukturën e duhur për të realizuar një transaksion sipas parimit DVP

3.6 Zbatimi i faktorëve të ekzekutimit do të ndryshojë në varësi të tregtimit në tregje të caktuara, për shembull tregjet ku informacioni para tregtimit (pre-trade) është jashtëzakonisht i kufizuar dhe tregjet ku informacioni (pre-trade) është gjerësisht i disponueshëm dhe shumë

transparent, ose për instrumente jolikuide në krahasim me për tregtimin e instrumenteve ku ka një nivel të lartë të likuiditetit.

3.7 Shoqëria do të përdorë ekspertizen dhe përvojën e saj për të arritur rezultatin më të mirë në të gjithë gamën e plotë të faktorëve; përfshirë këtu ku mund të bien ndesh me njëri-tjetrin.

Në përgjithësi, kjo mund të nënkuptojë që Shoqëria mund të mos arrijnë gjithmonë ekzekutimin më të mirë (duke marrë parasysh karakteristikat e cdo urdhëri) për çdo transaksion, pavarësisht përpjekjeve për të kërkuar ekzekutimin më të mirë.

## Neni 4

### Bashkimi i Urdhërave

4.1 Nëse Shoqëria bashkon urdhrat për transaksione të dy ose me shumë fondeve nën administrim, atëherë Shoqëria duhet:

a) T'i shpërndajë instrumentet financiare sipas urdhrit të ekzekutuar në mënyrë të drejtë ndërmjet fondeve, urdhrat e të cilëve janë bashkuar, në përpjesëtim me vlerën e secilit urdhër individual;

b) Nëse si rezultat i bashkimit, totali i urdhrave të ekzekutuar nuk korrespondon me totalin e urdhrave të kërkuar, shuma e instrumenteve financiare të blerë ose të shitur duhet të shpërndahen në mënyrë proporcionale tek secili fond në përpjesëtim me vlerën e urdhrit të kërkuar për secilin prej tyre;

c) Të mbartë pjesën e paekzekutuar të urdhërit të bashkuar në ditën tjetër kur tregtimet janë të mundshme dhe pastaj të aplikohet parimi i përcaktuar në shkronjën a), të kësaj pike.

4.2 Shoqëria nuk duhet të bashkojë një urdhër për fondin/fondet nën administrim me urdhrat për fondet e veta, përveç rastit kur një bashkim i tillë kryhet në përputhje me rregulloret e nxjerra nga Autoriteti ose tregu i rregulluar.

## Neni 5

### Përzgjedhja e vendit të tregtimit

5.1 Urdhërat do të ekzekutohen nga nëpërmjet Brokerave/Dealerave me të cilët Shoqëria ka marrëdhënie. Shoqëria do të përzgjedhë vendin e tregtimit duke marrë në konsideratë koston e transaksionit dhe sa më poshtë.

- Performancën e ekzekutimit bazuar në analizën Post Trade të ekzekutimeve me atë broker
- Aftësia për të gjetur likuiditet
- Cilësia e komunikimit dhe gadishmëria e brokerit për të kryer transaksione
- Analiza e Riskut të Brokerit

5.2 Shoqëria ka diskrecion në përzgjedhjen e cdo lloji vendi tregtimi nga lista e aprovuar e Brokerave që gjykon se do të përmbushë kërkesat e ekzekutimit më të mirë

5.3 Vende të reja tregtimi mund të shtohen pas një procesi aprovimi. Ky proces aprovimi përfshin rishikimin e pasqyrave financiare të brokerit, reputacionin, etj.

5.4 Një listë me vendet e tregtimit në lidhje me cdo klasë të instrumentave financiare me të cilat Shoqëria do të vendosë rëndësi të vecantë i bashkëlidhet kësaj politike/procedure. Shoqëria rezervon të drejtën e ndryshimit të këtyre vendeve të tregtimit dhe rishikimit të listës.

5.5 Kur politika e ekzekutimit të urdhrave parashikon mundësinë që urdhrat mund të ekzekutohen jashtë tregut të rregulluar ose platformave shumëpalëshe të tregtimit (PSHT), shoqëria administruese e fondeve duhet t'i informojë investitorët në lidhje me këtë mundësi përmes publikimit të kësaj politike në faqen e internetit të shoqërisë.

## **Neni 6**

### **Tregtimi në lidhje me aksionet**

Shoqëria do të ekzekutojë transaksione në aksione të cilat janë të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar duke tregtuar në një nga vendet e tregtimit të përcaktuar në Aneksin 1. Shoqëria vendos urdhërin nëpërmjet Brokerave me të cilët ka marrëdhënie.

Vendet e tregtimit të përcaktuara në Aneksin 1 nuk janë shteruese, dhe ky aneks përditësohet në mënyrë të vazhdueshme nga Shoqëria.

## **Neni 7**

### **Tarifat dhe kostot**

Shoqëria nuk do të pranojë asnjë lloj tarife, komisioni apo pagesë shumash monetare nga palë të treta që lidhen drejtpërdrejt me ekzekutimin e urdhërave të saj.

## **Neni 8**

### **Rishikimi i Procedurës së Ekzekutimit më të mirë**

Shoqëria monitoron dhe rishikon rregullisht efektivitetin e kësaj procedure me cilësinë e ekzekutimit, dhe ku është e nevojshme korrekton cdo lloj problematike

Shoqëria rishikon procedurën të paktën një herë në vit. Ky rishikim do të kryhet sa herë që ka një ndryshim material që ndikon Shoqërinë për të përmbushur detyrimin e saj për të siguruar ekzekutimin më të mirë.

Ndryshim material do të konsiderohet cdo ngjarje e rëndësishme që mund të ndikojë parametrat për të realizuar ekzekutimin më të mirë të tilla si kosto, cmimi, shpejtësia, probabiliteti i ekzekutimit dhe shlyerja, madhësia, natyra ose cdo lloj konsiderate tjetër relevante në lidhje me ekzekutimin e urdhërit.

Shoqëria do të vlerësojë dhe do të analizojë vende të reja të tregtimit dhe brokera të tjerë rregullisht dhe do të përditësojë listën e përcaktuar në aneksin 1 menjëherë.

## Aneksi 1

### Vendet e Ekzekutimit të Urdhërave

Shoqëria përdor vendet e ekzekutimit të renditura më poshtë kur kërkon të marrë ekzekutimin më të mirë në përputhje me këtë politikë. Lista e mëposhtme nuk është shteruese dhe do të ndryshojë sa herë që Shoqëria e konsideron të nevojshme për të siguruar që vendet e mëposhtme janë të përshtatshme për të mbuluar nevojat e biznesit dhe për të siguruar që janë marrë të gjithë hapat e mjaftueshëm për të arritur ekzekutimin më të mirë për klientët. Në veçanti, vende të tjera mund të shtohen herë pas here.

Lloji i Instrumentit	Vendet e Ekzekutimit
Tituj të Qeverisë Shqiptare	Bursa ALSE Tregu Nderbankar Ankandet e Titujve të Republikës së Shqipërisë
Aksione të tregtuara jashtë Republikës së Shqipërisë	NYSE – Neë York Stock Exchange, NSDQ – Nasdaq Stock Market, NYSE ARCA NYSE American (formerly NYSE MKT dhe American Stock Exchange AMEX) BATS-Z (BZX) Exchange BATS-Y (BYX) Exchange EDGA Exchange EDGX Exchange NASDAQ OMX PHLX (Philadelphia Stock Exchange) NASDAQ OMX BX (Boston Stock Exchange) Chicago Stock Exchange (CHX) Investors Exchange (IEX) ArcaEdge (ARCAEDGE) BATS Europe (BATECH) Bats Europe (BATEDE) Bats Europe (BATEEN) Bats Europe (BATEES) Bats Europe (BATEUK) Bolsa de Madrid (BM) Budapest Stock Exchange BVL CHI-X Europe Ltd Clearnet (CHIXEN) CHI-X Europe Ltd Clearnet (CHIXES) CHI-X Europe Ltd Clearstream (CHIXDE) CHI-X Europe Ltd Crest (CHIXUK) CHI-X Europe

	<p>Ltd Sëiss (CHIXCH) ENEXT.BE Euronext France (SBF) Euronext NL Stocks (AEB) Frankfurt Stock Exchange (FËB) London Stock Exchange (LSE) LSE International Order Book (LSEIOB1) Nasdaq Baltic (N.RIGA) Nasdaq Baltic (N.TALLINN) Nasdaq Baltic (N.VILNIUS) OMXNO SIX Sëiss Exchange (EBS) Stuttgart Stock Exchange (SËB) Sëedish Stock Exchange (SFB) Tradegate Exchange (TRADEGATE) Turquoise (TRQXEN) Turquoise CH (TRQXCH) Turquoise DE (TRQXDE) Ëarsaë Stock Exchange XETRA (IBIS) Alpha ATS (ALPHA) Canadian Securities Exchange CHI-X Canada Montreal Exchange (CDE) Omega ATS (OMEGA) Toronto Stock Exchange (TSE) TSX Venture (VENTURE) Australian Stock Exchange (ASX) CHI-X Australia Hong Kong Stock Exchange (SEHK) National Stock Exchange of India (NSE) CHI-X Japan Osaka Exchange (OSE.JPN) Tokyo Stock Exchange (TSEJ) Singapore Exchange (SGX) Korea Stock Exchange (KSE)</p>
<p>Obligacione të tregtuara jashtë Republikës së Shqipërisë</p>	<p>Bloomberg, Reuters (përmes broker)</p>

**Brokerat me të cilët vepron ABI Invest**

**Per titujt e tregtuar jashtë Republikës së Shqipërisë**

Banka Amerikane e Investimeve  
Adamant Capital Partners AD

**Per titujt e tregtuar në Republikën e Shqipërisë**

**a) Në Bursën ALSE**

Banka Depozitare (nëse është anëtare)

**b) Në tregun ndërbankar**

Banka Depozitare